



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.2.2022, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Antoneta Dhima, Anila Denaj, Pranvera Resulaj, Shpresa Marnoj, Enslemvera Zake, Dashamir Shehi, Bujar Leskaj, Edmond Spaho, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Blerina Gjylameti dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Erion Braçe, Benet Beci, Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Alban Xhelili dhe Agron Shehaj.

Të ftuar:

Meri Kumbe - Zëvendësministre e Kulturës

Borana Ajazi – Drejtorja e të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës

Vilma Çaushtolli - Përgjegjëse sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Siç jeni vënë në dijeni, sot do të shqyrtojmë nen për nen projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””.
Relatore është zonja Emilja Koliqi.

Nga Ministria e Kulturës kemi të ftuar zonjën Meri Kumbe, zëvendësministre, si dhe zonjën Borana Ajazi nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit, të cilave u uroj mirëseardhjen në komision!

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi të ftuar zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore.

Mirë se erdhët në komision!

E kemi filluar disa ditë më parë shqyrtimin e projektligjit. Pas prezantimit dhe miratimit në parim të ligjit kishte një numër të konsiderueshëm pyetjesh drejtuar Ministrisë së Kulturës, duke filluar nga relatorja, zonja Koliqi. Besoj se i keni mbajtur shënim të gjitha pyetjet. Sapo u vura në dijeni që një pjesë e tyre janë shpërndarë edhe me *e-mail*.

Do të doja t’ju jepja fjalën për t’iu përgjigjur pyetjeve një e nga një, por duke cituar edhe deputetin që ju ka drejtuar pyetjet. Më pas do të vijojmë me kolegët, nëse do të kenë pyetje, sqarime të mëtejshme, para se të shkojmë te diskutimet apo në votimin nen për nen.

E nderuar relatore, a keni diçka për të shtuar në lidhje me rendin?

Emilja Koliqi – Jo. Faleminderit, kryetar!

Presim përgjigjet.

Eduard Shalsi – Zonja Kumbe, fjala për ju.

Meri Kumbe – Mirëmëngjesi! Faleminderit!

Nisim me pyetjet e drejtuara nga relatorja, zonja Koliqi.

Pyetja e parë ishte: “Si është kryer përlogaritja e shpenzimeve për ngritjen e sistemit të databazës?”.

Ministria e Kulturës, si përfituese, dhe Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit, si autoritet konkurrues, kanë hartuar termat e referencës për projektin “Platforma e të drejtës së autorit” dhe në këtë platformë është parashikuar të përfshihet dhe databaza e veprave pa autor.

Për sa i përket pyetjes së dytë: “Çfarë nënkuptoni me kontratat e partneritetit publik-privat?”, duam t’ju sqarojmë se, marrëveshjet kontraktuale, të parashikuara në këtë projektligj, synojnë nxitjen e digjitalizimit, por në asnjë rast nuk parashikojnë dhe nuk përfshijnë kontribute financiare, pra për sa u përket përfitimeve. Përfitimet u shkojnë gjithmonë autoriteteve shtetërore.

E treta: “Duhet të saktësohen materialet, koha se kur do të fillojnë efektet financiare”.

Projektligji përcakton se rregullimi i procedurës për mënyrën e kompensimit të drejtë do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda afatit 1-vjeçar nga hyrja në fuqi e projektligjit për të drejtën e autorit. Efektet financiare për veprat pa autor nuk mund të përcaktohen në kohë. Gjithashtu, nuk mund të parashikohet numri i veprave që do ta marrin këtë status, si dhe nuk mund të parashikohet se sa prej veprave pa autor mund t’u gjendet autori rrugës. Kështu që nuk mund të kemi një përcaktim të qartë në këtë moment.

Eduard Shalsi – Më falni, një sekondë!

Zonja Koliqi, nëse doni të bëni ndonjë ndërhyrje pas çdo përgjigjeje të pyetjeve, për ndonjë saktësim, që të mos rikthehemi, mund ta bëni.

Emilja Koliqi – Për pyetjen e parë, për 16-milionëshin, për investimin fillestar, unë kërkova një preventiv, pak a shumë, se çfarë zërash përmend ky preventiv që arrin në këtë shumë. Gjithashtu, unë thashë që në listën e investimeve të buxhetit 2022-2024 nuk ishte si emërtim ky lloj investimi.

A mund të më sqaroni për këtë, ju lutem, si dhe për çështjen e mirëmbajtjes, se përse është llogaritur deri në vitin 2030?

Meri Kumbe - Për momentin ai është një parashikim i bërë nga AKSHI, lidhur me studimin e tregut. Për të pasur një parashikim të saktë buxhetor duhet të kemi konkluduar procesin dhe të shkojmë tek termat e referencës. Kjo është arsyeja se përse ju nuk e keni gjetur në projektbuxhet. Gjithsesi, unë e kisha të listuar te pyetjet e mëposhtme, se i kemi zbardhur të gjitha pyetjet e adresuara nga ju në seancën e kaluar. A mund të vazhdoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për pyetjen e dytë, aktet nënligjore janë ato që do t’i rregullojnë, brenda një viti që nga momenti i kalimit të projektligjit.

Pyetja e katërt ishte: “Kush e përcakton shumën e kompensimit për veprën pa autor?”.

Para hartimit të aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë procedurën e kompensimit të drejtë në rastin e veprave pa autor, do të merren në analizë disa sisteme të Bashkimit Europian. Gjithashtu, do të merret në referencë dhe vlera e të ardhurave për një autor nga agjencitë e administrimit kolektiv, pra do të dali në krahasim, se çfarë modelesh reference kemi në botë dhe cilat janë shpërndarjet në Shqipëri.

Emilja Koliqi – Cili është autoriteti që do ta përcaktojë vlerën e kompensimit? Sepse nuk është e shprehur.

Meri Kumbe – Do të përcaktohet në aktet nënligjore nga Ministria e Kulturës dhe nga institucionet e tjera që preken nga kjo kategori.

E pesta: “Në pikën 3/c të nenit 16/1 janë parashikuar veprat kinematografike ose vepra të tjera audiovizive dhe fonogramet e prodhuara nga transmetuesit publikë deri më 31 dhjetor 2002, duke përfshirë këtë datë, që gjendet në arkivat e tyre. Përse është vendosur kjo datë në ligj?”.

Data 31 dhjetor 2002 është datë e ardhur nga direktiva e Bashkimit Europian. Nuk është një datë e vendosur nga ne, është thjesht e zbatuar nga ana jonë. Është marrë kjo si datë reference, sepse ky problem ka lindur pikërisht me digjitalizimin. Kështu që vetë Bashkimi Europian, në direktivën e tij ka vendosur të marrë këtë datë si pikë reference për të aplikuar këto të drejta.

E gjashta: “Sporteli unik krijohet si subjekt juridik dhe regjistrohet si organizatë jofitimprurëse. Në projektligj është parashikuar në pikën 5 të nenit 8 që, nëse nuk arrihet një vendimarrje mes AAK-ve për përzgjedhjen e organit më të lartë ekzekutiv brenda afatit të përcaktuar, këtë vendimarrje e realizon Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente, bazuar në kritere të miratuara prej tij”.

Jeni shprehur se nuk është e qartë, sepse duket sikur ndërhyhet në ligjin për organizatat jofitimprurëse. Projektligji “Për të drejtat e autorit” është dërguar për mendim tek të gjitha institucionet e linjës me të cilat është bashkërenduar. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet sistemit elektronik *e-Akte* ka përcjellë komente për këtë projektligj. Ndër komentet është sugjeruar të rishikohet neni 138 në raport me përcaktimin e ligjit nr.8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar”. Konkretisht, sugjeron rishikimin e parashikimeve në projektligj, ku i jepet e drejta Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për përzgjedhjen e organit më të lartë ekzekutiv, si dhe parashikimin, ku përcaktohet se ministri, me udhëzim, përcakton mënyrën e funksionimit dhe organizimit të sporteli unik. Në lidhje me rishikimin e nenit 138, në raport me

ligjin nr.8788 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar” është sqaruar dhe argumentuar se pika 5 e këtij neni parashikon një procedurë, e cila vjen si domosdoshmëri e konstatuar nga aplikimi në praktikë i këtij ligji. E drejta e autorit është një e drejtë private, e cila ka një ndikim shumë të rëndësishëm publik. Roli i shtetit në raport me Agjencinë e Administrimit Kolektiv është garantues i ushtrimit të aktivitetit të administrimit kolektiv.

Pyetja e shtatë: “Sa agjenci të administrimit kolektiv të regjistruara janë sot?”.

Aktualisht kemi 4 agjenci të licencuara: Albautor, AKDIE, FMAA dhe Faber Collective Phonogram.

Pyetja e tetë: “A ka një raport monitorimi për këto agjenci të licencuara, duke qenë se ndryshimet ligjore janë bazuar në monitorimet, gjetjet dhe shkeljet? Çfarë frekuence ka ky monitorim dhe nga kush kryhet?”.

Ligji nr.35/2016 ka parashikuar se Drejtoria për të Drejtën e Autorit kontrollon një herë në vit veprimtarinë e agjencive të administrimit kolektiv. Drejtoria mund të kryejë edhe kontrole të posaçme. Agjencitë kanë detyrimin e depozitimit të bilancit vjetor deri në datën 31 mars të çdo viti pasardhës. Pas depozitimit, Ministria e Kulturës ngre grupin e punës për analizën e të gjitha aspekteve ligjore dhe financiare të agjencive. Ndryshimet ligjore të propozuara, pa dyshim, janë bazuar në këto raporte, ku janë analizuar të ardhurat, shpenzimet dhe shpërndarjet e secilës prej agjencive të licencuara.

Pyetja e nëntë: “A monitorohen institucionet publike për të drejtat e autorit, për shembull, teatrot apo organizimet e tjera të institucioneve publike?”.

Patjetër që Ministria e Kulturës, në mënyrë të vazhdueshme, sjell në vëmendje të institucioneve të kulturës, por edhe të bashkive në të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë zbatimin e ligjit. Ndërkohë, më lejoni t’ju them se të gjitha institucionet artistike në vend vetëmenaxhohen nga bordet artistike, që janë dhe organet kompetente për të siguruar të drejtat e autorit. Kjo do të thotë që, nëse një vepër skenike nuk ka të drejtën e autorit, bordi nuk duhet ta kalojë atë për t’u vënë në skenë.

Pyetja e dhjetë: “A ka bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë për të Drejtat e Autorit dhe AMA-s për aktivitetin e subjekteve përdoruese transmetuese, për respektimin e të drejtës të transmetimit? Sa raste ka pasur dhe çfarë hapash janë ndjekur? Sa janë masat administrative?”.

Ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” parashikon se ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të respektojë të drejtat e autorit në përputhje me

legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to. Mosrespektimi i kësaj të drejte përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë. Gjithashtu, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut kryen inspektimet në subjektet përdoruese të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të lidhura me to dhe ka kompetencat e vendosjes së masave administrative bazuar në dispozitat e ligjit nr.35/2016. Drejtoria e të Drejtave të Autorit nuk ka kompetence në vendosjen e masave administrative ndaj subjekteve që shkelin të drejtën e autorit.

Pyeta e njëmbëdhjetë: “A është bërë ndonjë përpjekje për përfshirjen në kurrikulat e arsimit edukimi për respektimin e të drejtës së autorit?”.

Pa dyshim, strategjia kombëtare e pronësisë intelektuale 2021-2025 parashikon dhe hartimin e kurrikulave, materialeve mësimore dhe moduleve për nxënësit, mësuesit, studentët dhe stafin akademik. Këto ishin pyetjet tuaja. Faleminderit!

Kryetar, mund të procedojmë me...

Eduard Shalsi – Një sekondë! Nëse zonja Koliqi është dakord me përgjigjet dhe në qoftë se do ndonjë shpjegim më tej... Jo? Dakord. Faleminderit!

Mund të vijomë me përgjigjet e pyetjeve të tjera.

Meri Kumbe – Pyetje nga zonja Antoneta Dhima.

Pyetja e parë: “A është konsultuar ky projektligj me grupet e interesit? Pasi në relacionin që e shoqëron thuhet se projektligji parashikohet të hyjë në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, me qëllim njohjen nga institucionet dhe subjektet e interesuara”.

Për konsultimin e projektligjit janë ndjekur të gjithë hapat e parashikuar në legjislacion. Në datën 15.10.2020 është dërguar për mendim projektligji dhe relacioni shoqërues tek të gjitha palët e interesuara për komente dhe rekomandime. Gjithashtu, është publikuar në regjistrin elektronik në datën 23.10.2020. Janë zhvilluar tri takime konsultive me agjencitë e administrimit kolektiv, konkretisht, më 26 tetor, më 28 tetor dhe më 30 tetor të vitit 2020. Palët e interesuara janë përgjigjur, sipas rregullores, brenda 20 ditëve nga data e njoftimit, duke dorëzuar komente dhe rekomandime. Ky afat ka qenë i parashikuar në datën 19.11.2020. Në përfundim të këtij afati projektligji u dërgua për mendim në të gjitha ministrinë e linjës.

Pyetja e dytë: a është parashikuar vlera në buxhet dhe si është bërë përlllogaritja e vlerës për bazën e të dhënave? A ka nevojë t’i rikthehem kësaj pike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Pyetja tjetër: në projektligj është parashikuar përqindja e shpërndarjes së tarifës 40-30-30, kush ka të drejtën e shpërblimit të mëtejshëm për tarifën që do të mblidhen?

Projektligji parashikon që sporteli unik mbledh në emër të agjencive të administrimit kolektiv të ardhura, të cilat shpërndahen në mënyrën e përcaktuar kundrejt agjencive të administrimit kolektiv. Agjencitë kanë detyrimin të shpërndajnë, sipas rregullave të tyre, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit, në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave të të drejtave të lidhura me to.

Ligji parashikon se shpenzimet totale të agjencive nuk mund të përbëjnë më shumë se 30% të shpërblimeve të shpërndara.

Pyetja e katërt: a mendoni se kërkimi shterues do të jetë efektiv, duke qenë se do të kryhet nga personeli, apo duhet të ketë stimul?

Përgjithësisht, nga legjislacionet e studiuara për përafrimin e direktivës është vënë re se kërkimi shterues kryhet me burime njerëzore të vetë institucioneve. Ne besojmë se edhe në vendin tonë personeli i institucioneve do ta kryejë këtë kërkim shterues të saktë dhe në mënyrë efektive.

Këto ishin pyetjet e zonjës Dhima.

Pyetjet nga deputeti Spaho:

A mbulohet e drejta e imazhit nga e drejta e autorit?

Nëse merr pjesë në një spot për qëllime artistike, a mund të përdoret imazhi nga të tretë për një spot tjetër, madje edhe për qëllime politike?

E drejta e imazhit nuk mbulohet nga e drejta e autorit. Objekti i së drejtës së autorit është çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, që bart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tyre.

A mund të vazhdoj?

Edmond Spaho – Pra, unë kam të drejtë të marr imazhin tuaj si zëvendësministre, ta përdor në një spot të Partisë Demokratike dhe të them se ju po bëni thirrje për të votuar PD-në? E kuptova drejt?

Meri Kumbe – Nuk është pjesë e këtij projektligji. Kjo e drejtë nuk mbulohet nga ky ligj.

Pyetjet e zonjës Zake:

E para: a ka mundësi që veprat pa autorë të bëhen pronë private e disa individëve dhe më pas të tregtohen për qëllime përfitimi tek të tretët? Cili është mekanizmi që i pengon ata për t'i marrë dhe për t'i përdorur për qëllime përfitimi?

Riprodhimi i veprave pa autorë do të kryhet nga institucionet e parashikuara në këtë projektligj dhe këto institucione janë pikërisht përgjegjëse për të kryer kërkimet shteruese. Pas kësaj procedure, vepra merr statusin si vepër pa autor. Nga momenti që vepra merr këtë status reflektohet në bazën e të dhënave *online* me akses të hapur. Kjo është një mënyrë për të evidentuar çdo lloj përdorimi të padrejtë të veprës.

Pyetja e dytë: veprat pa autorë do të citohen si të tilla pas kërimit shterues me mirëbesim. Si do të matet mirëbesimi?

Direktiva ofron shumë pak interpretim për kërkimin shterues dhe se kur ai do të quhet i kryer në mirëbesim. Në direktivë paraqitet një strategji e caktuar për të interpretuar kërkimin shterues në mirëbesim.

Në nenin 2 të direktivës përcaktohet se duhen caktuar burimet e kërimit për të garantuar që institucionet, të cilat kryejnë këtë veprim, të jenë në mirëbesim.

Pikërisht neni 16/3 i projektligjit përcakton burimin e kërimit shterues.

Në vijim, punonjësit, pjesë e institucioneve që do të bëjnë kërkimin shterues, do të mbajnë të dhëna për kërkimet e veprave pa autorë, të cilat do të jenë të reflektuara.

Pyetjet e zonjës Pranvera: si ka qenë regjistrimi i individëve për të drejtën e autorit dhe si është vjelja e të ardhurave për të ardhurat personale? Si monitorohet dhe si ka qenë ndikimi i këtyre të ardhurave në buxhetin e shtetit?

Ligji nr. 35/2016, në nenin 137, shkronjat “h” dhe “j” përcakton se për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit, që u paguhen në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, agjencitë detyrohen të mbajnë dhe të paguajnë për llogari të administratës tatimore tatime në burim në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi tatimin e të ardhurave. Ministria e Kulturës nuk disponon informacion për ndikimin e këtyre të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Pyetjet e zotit Leskaj: a mund të bëni një përmbledhje të problematikave që ka ngritur komisioni i kulturës për sa u përket amendimeve të këtij ligji?

Duke pasur në konsideratë se roli dhe funksionimi i tyre sipas ligjit ka një rëndësi themelore për zbatimin e të drejtave të autorit, pikërisht për amendimet ka qenë: te parashikimi i normës ligjore për ngritjen e SUADA-s, përfaqësimin e administrimit të të drejtave nga agjencitë

e administrimit kolektiv, shmangien e konfliktit të interesit, mënyrën dhe përqindjen e ndarjes së tarifës për shpërblimin e mbledhur ndaj AAK-ve. Gjatë monitorimeve janë konstatuar një larmi problematikash, që më së shumti lidhen me mungesën e transparencës në mbledhjen dhe shpërndarjen e tarifave për përdorimin e të drejtës së autorit, të anëtarëve dhe joanëtarëve të agjencisë; mungesë transparence për subjektet ku vilet kjo tarifë; mungesë informacioni dhe besimi në mënyrën se si funksionojnë agjencitë, ndaj kemi kërkuar amendimin e këtij ligji, ku shprehim: Vetëm me pëlqim të shkruar të përfituesve, me lista të specifikuara të të drejtave që autorizohen të administrojnë. Pra, pritet që agjencitë të funksionojnë vetëm për post pëlqimit të shkruar.

E dyta: sa mbrapa, pra sa dobët jemi në këtë fushë?

Këtë e tregon fakti në relacionin shpjegues për numrin 134 të anëtarëve në rang shteti, që kanë marrë një shumë prej 68 mijë lekësh të rinj në periudhën 2 vjet përfitimi.

Për sa i përket kompensimit të përdorimit të së drejtës së autorit në momentin kur vepra nuk e gëzon më statusin si vepër pa autor, kompensimi kryhet nga institucionet, si bibliotekat me akses publik, institucionet arsimore, muze, persona juridikë, që kryejnë veprimtari muzeore, arkiva, institucione arkivore filmike, audio-vizuale dhe ofruesit e shërbimit. Ky është thjesht një numër dhe marr shembull, për të bërë një llogari të përafërt, i përket vetëm një kategorie të së drejtës së autorit dhe vetëm një agjencie të administrimit kolektiv.

Të dhënat i referohen Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit për periudhën kohore 2-vjeçare. Sipas deklarimeve të vetë agjencisë për shumën e shpërblimeve të shpërndara për mbajtësit e të drejtave, janë marrë në referim shpërblimet e shpërndara për autorët të shprehura në milionë lekë gjatë dy vjetëve. Numri i autorëve, që kanë përfituar shpërblim për të drejtën e autorit, ka qenë 134 dhe, si i tillë, janë llogaritur të ardhurat që përfiton secili prej tyre. Duke iu referuar të dhënave, të ardhurat janë mesatarisht 68 mijë lekë në një periudhë kohore 2-vjeçare.

Pyetja numër 3: kërkoni të revokoni nenin 177 dhe nuk jeni shumë të qartë?

Ky nen është modern, ndaj, nëse keni mundësi na jepni sqarime shtesë lidhur me kodet e standardeve dhe të konformitetit të produkteve, që lidhen me zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura me to. Kështu shprehet deputeti, i cili duket se ka pak dyshime.

Në nenin 177 të ligjit nr. 35/2016 kodet e standardeve dhe të konformitetit të produkteve, që lidhen me zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura me to, përcakton se organet

kompetente shtetërore dhe subjektet e autorizuara prej tyre hartojnë dhe miratojnë kodet teknike, me qëllim që të garantojnë mbikëqyrjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, veçanërisht ato të fiksuara në këtë optikë.

Në datën 14 dhe 15 shtator të vitit 2017 në Tiranë u organizua një ekspertizë e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale për çështjet teknike që i përkasin legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Specifikisht, në raportin përfundimtar për parashikimet e nenit 177 eksperti është shprehur se zbatimi i një sistemi të ngjashëm certifikimesh dhe regjistrimesh do të ishte shumë i ndërlikuar, nga njëra anë, dhe jo efikas për tregun shqiptar, nga ana tjetër. Ju lutem, këtu të mbajmë në konsideratë faktin se në vendet e rajonit apo në vende të tjera europiane ka rezultuar se nuk ka sisteme të ngjashme të zbatuara apo të rregulluara, sikurse parashikohet në nenin 177. Rasti i vetëm është ligji bullgar, që trajton rregullimin administrativ të prodhimit dhe tregtimit të disqeve optike apo mjeteve të tjera që përmbajnë objekte të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

Me zhvillimin teknologjisë dhe përdorimin e internetit, është modifikuar edhe koncepti i piraterisë. Mund të themi se disqet optike nuk janë më një mjet kryesor, që përbëjnë piraterinë në shtetin shqiptar.

Pyetja numër 4 : a do të ishte më e përshtatshme që në nenin 179, pika 11, të ligjit, që lidhet me kundërvajtjen administrative, të ardhurat e gjobave të mos derdhen në buxhetin e shtetit, por të shpërndahen tek artistët për të ngritur nivelin, i cili është afër zeros?

Në fakt, sipas ligjit në fuqi, e drejta e autorit shpërndahet në bazë të përdorimit, kurse gjobat vendosen në bazë të një vendimmarrje administrative. Si rrjedhojë, është e pamundur që ato të shpërndahen, pasi këtu do të humbim ato që ligji parashikon për shpërndarjen e drejtë, bazuar në përdorim.

Pra, nëse një muzikë përdoret 10 herë dhe nga sporteli i SUADA-ës vilet kjo e drejtë, të ardhurat nga ky përdorim do të shpërndahen dhe artistit do t'i shkojë sasia e parave që i korrespondon numrit të caktuar të përdorimit. Kështu që gjobat në këtë rast vendosen në formë administrative, pra janë shkelje që konstatohen nga organet përkatëse dhe vendosen bazuar në një vendimmarrjeje administrative. Kështu, nëse do t'i kalonim në arkën e shpërndarjes, këtu do të humbiste barazia, më saktë raporti që do të kishim nga vjelja e të ardhurave dhe nga dhënia mbrapsht e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Pyetja numër 5: fakti që ju fusni koncepte për të drejtën pa autor dhe shtoni edhe konceptin e partneriteteve private, ju lutem, sqaroheni se çfarë janë? Nuk e di se çfarë prapavije ka dhe nuk mund të flasim dot, por duhej të ishit më e qartë.

Mendoj se kësaj pyetjeje iu përgjigja që në fillim, pasi e shtroi edhe relatorja, por, nëse e gjykoni, mund t'i rikthehem.

Pyetja numër 7: gjatë kësaj periudhe Ministria e Kulturës, SUADA dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit, a kanë shtuar fonde për trajnime dhe rritjen e performancës së punonjësve të Zyrës për të Drejtat e Autorit?

Patjetër, janë bërë trajnime në forma të vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë dhe aktivitete të përbashkëta me struktura të tjera të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Strategjia Kombëtare për të Drejtën e Pronësisë Intelektuale ka të përcaktuar një kalendar specifik për zhvillimin e zyrës në lidhje me përmirësimin e njohurive për të drejtën e autorit.

A të vazhdoj me pyetjet e zotit Agalliu?

Eduard Shalsi – Po, vazhdoni.

Meri Kumbe – Në rregull!

Pyetja numër 1: nëse nxirret në shitje, ankand ose dhurohet një vepër pa autor, a do t'i nënshtrohet kërimit shterues, apo do të merret i mirëqenë fakti që është vepër pa autor?

Në asnjë rast statusi i veprës pa autor nuk merret i mirëqenë. Ai status përfitohet vetëm pas kërimit shterues dhe, pasi mbaron kjo fazë dhe gëzon këtë status, futet në databazën e të dhënave online. Vetëm atëherë mund të kalojë në procese të tjera, siç mund të jetë ankandi, por që nuk është subjekt i këtij ligji.

Pyetja numër 2: kush i përcakton kostot e digjitalizimi? Të mos të jetë kjo PPP, që do të bëjë digjitalizimin dhe më pas, në emër të interesit publik, të merret me shitjen këtyre veprave pa autor.

Sikurse e thashë, sepse është sërish një pyetje adresuar nga disa deputetë, kostot e digjitalizimit nuk bëhen nga Ministria e Kulturës, bëhen në bashkëpunim me institucionet e shtetit shqiptar përgjegjëse për këtë proces. Në të gjitha rastet, nëse një partner dëshiron të sponsorizojë procesin e digjitalizimit, të ardhurat nga veprat pa autor u shkojnë vetëm institucioneve bartëse, pra pronare të këtyre veprave, dhe të ardhurat nga to do të përdoren sërish për qëllime të digjitalizimit dhe të publikimit të këtyre veprave në interes të informimit publik.

Pyetja numër 3 ka të bëjë me sportelin unik. Pse duhet një sportel? A ka ndonjë mundësi tjetër?

Në fakt, ky sportel është një risi e ligjit 35/2016, dhe është konceptuar si një sportel që krijon lehtësi për subjektet përdoruese dhe i shërben formalizimit të tregut intelektual. Gjithashtu, qëllimi tjetër është dhënia fund e konfuzionit që krijohet te përdoruesit, duke kryer pagesa te shumë agjenci njëherazi.

Pyetja numër 4 ka të bëjë me grupet e interesit: cilat janë grupet e interesit që janë pyetur dhe sa janë marrë parasysh ato? Si bëhet vjelja e kuotave në një restorant të caktuar? Mos ka abuzim? Cili është mjeti që bën diferencën mes asaj që përdoret dhe asaj që paguhet?

Lidhur me pyetjet për grupin e interesit, i parashtruam pak më sipër me data specifike, ndërsa sa i përket vjeljes së kuotave, ato janë të standardizuara përmes një procesi të posaçëm dhe shkojnë në raport me mënyrën dhe në vendin e përdorimit. Pra, një restorant më i madh krahasuar me një më të vogël, një restorant me punë sezonale krahasuar me një restorant me punë permanente gjatë gjithë vitit. Kështu që, janë të rregulluara përmes një procedure të posaçme dhe metodologjisë së tarifave. Këto ishin edhe pyetjet tuaja. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Shumë faleminderit për përgjigjet!

A ka ndonjë koleg diçka për të shtuar, për të sqaruar, për të komentuar?

Po, zoti Agalliu, fjala është për ju.

Arbi Agalliu – Unë nuk dua të gjykoj asnjë përgjigje, sepse gjithsecili që ka bërë pyetjen merr përsipër ta gjykoj përgjigjen, por unë dua të them se nga dita e parë që ne jemi në këtë komision deri sot, zonja Kumbe është personi i parë që u jep përgjigje të gjitha pyetjeve, një për një, në emër të çdo deputeti. Kështu që, dua, kryetar, që ky lloj standardi i vendosur sot të kthehet në një traditë për komisionin, pastaj në raport me përgjigjet, gjithsecili gjykon sipas mendimit të tij.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Zoti Leskaj, fjala është për ju.

Bujar Leskaj – Zoti Agalliu, si sekretar i grupit, ju lutem, formalizojeni më qartë vlerësimin tuaj. Zonja zëvendësministre mund të ngrihet në detyrë apo ta shkarkojnë nesër këta?

Arbi Agalliu – Bazuar në historinë e kësaj qeverie, kush punon ndershëm dhe përgjigjet saktë, shkarkohet, por shpresojmë të mos vijohet kështu!

Eduard Shalsi – Natyrisht, momentet e humorit janë të nevojshme në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jam dakord që përgjigjet ishin të strukturuar, citonin çdo deputet dhe këtë u kemi kërkuar të gjithë përfaqësuesve që vijnë. Përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, të cilët i falënderoj për përgjigjet, patën edhe mundësinë që në kohë të analizonin më mirë pyetjet dhe për pasojë të përgatisnin përgjigjet. Nëse doni që një praktikë të tillë ta bëjmë më shpesh me ligje të ndryshme, do t'i lëmë kohë diskutimit në parim dhe diskutimit nen për nen të çështjeve.

Zonja Zake ka kërkuar fjalën.

Enslemvera Zake – Faleminderit edhe zëvendësministres për prezantimin!

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe fokusohemi kryesisht te çështjet financiare, por kam një sugjerim, i cili besoj se është dhënë edhe nga komisionet e tjera, që e kanë shqyrtuar në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, sepse nen për nen do ta shqyrtojmë, me propozimet dhe sugjerimet përkatëset, komisioni përgjegjës, që është Komisioni i Edukimit. Ka një mospërputhshmëri të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së, pasi përshtatja e tyre është e pjesshme. Kështu që, propozohet që tabela e papërputhshmërisë, e cila shoqëron projektligjin, duhet të korrigjohet nga institucioni propozues, pasi ka disa mangësi referuar kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi “Për instrumentet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE”, referuar nenit 17, pika 2, dhe nenit 3 të ligjit nr. 15/2015.

Gjithashtu, ka edhe disa probleme të teknikës legjislative, të cilat ne do t'i propozojmë te komisioni përkatës. Kështu që, meqenëse këtu jemi komision për dhënie mendimi, nuk po ndalemi.

Për sa u përket kostove financiare, për të vijuar edhe te pyetja që paraqiti kolegja Koliqi, kostoja e ngritjes së sistemit është në vlerën 16 milionë për vitin e parë dhe më pas për vitin e dytë kostoja e mirëmbajtjes së sistemit është 3,2 milionë dhe për vitin e tretë është po e njëjta kosto 3,2 milionë kosto për mirëmbajtjen e sistemit. Këto fonde janë parashikuar në buxhetin e shtetit në ministrinë e linjës dhe do të mbulohen gjithashtu nga buxheti i shtetit.

Këto ishin disa sqarime. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Zake!

Keni diçka për të shtuar apo komentuar?

Zoti Leskaj, fjala për ju.

Bujar Leskaj – Meqenëse na krijuat klimën e ngrohtë, kryetar, unë kam një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës. A i keni kërkuar qeverisë të filloni procedurat për

ratifikimin e Traktatit të Marakeshit për sa u përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, të verbërve e të tjerë, pasi ju këtu citoni direktivën e BE-së, ndoshta e keni implementuar pjesërisht, apo është burim i propozimit të politikës suaj te këto ndryshime? Si mendoni të ecni më tej për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar, ose ndryshe me aftësi të kufizuar në leximin e materialeve të printuara? Është jashtë teme, në fakt, por do të doja një përgjigje.

Meri Kumbe – Faleminderit për pyetjen, zoti Leskaj!

Është pikërisht pika e dytë e direktivës, që merret me rregullimin e të drejtave lidhur me personat me aftësi të kufizuar, sidomos në shikim. Detyrim kemi pikërisht përafrimin e direktivës së Bashkimit Europian dhe kemi gjykuar t'i japim prioritet, për atë kohë sa kemi edhe detyrim, dhe në vazhde kemi bërë disa takime për Traktatin e Marakeshit dhe, pasi të përfundojmë këtë proces, do të nisim me këtë traktat.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, duke falënderuar deputetët dhe përfaqësuesit e ministrisë për përgjigjet e pyetjeve, kalojmë në votimin nen për nen, sepse në parim e kemi votuar.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4?

Po, zonja Koliqi, fjala është për ju.

Emilja Koliqi – Në nenin 4 ka një ndryshim te neni 75, pika 2. Nëse jeni dakord për këtë ndryshim, për shumën e kompensimit, ne duhet ta riformulojmë: “Bibliotekat publike, institucionet arsimore ose muzetë, personat e tjerë juridikë, që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat, institucionet arkivore filmike ose audiovizuale dhe transmetuesit publikë, që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë, përcaktojnë shumën e kompensimit”.

Në lidhje me atë që ju thatë, që do të ketë një akt nënligjor për atë që do të përcaktojë shumën e kompensimit, a gjykoni që mund të vendoset në këtë mënyrë? Pra, sot është e shkruar: “Shuma e kompensimit e parashikuar në pikën 1...” dhe ta riformulojmë duke vendosur “...të

gjitha institucionet përcaktojnë shumën e kompensimit të parashikuar në pikën 1, sipas kategorive të veprave pa autor, duke marrë parasysh, ndër të tjera, qëllimet e promovimit kulturor, natyrën jofitimprurëse...” e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në këtë ligj të përcaktohen institucionet që do të bëjnë llogaritjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse pak më sipër janë të shkruara të gjitha institucionet, te neni 75, pika 1 “Përdorimi pa kufizim i veprave pa autor”, i përcakton të gjitha institucionet, nëse e gjykoni, të vendoset se kush e bën llogaritjen e shumës së kompensimit.

Meri Kumbe - Dakord, ne po e mbajmë shënim.

Emilja Koliqi – Unë po ju jap edhe riformulimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, e përcjellim te komisioni përgjegjës.

Eduard Shalsi – Zonja Zëvendësministre, po e dëgjoni relatorin?

Do ta përcjellim te komisioni përgjegjës, te Komisioni i Mediave, ku do të bashkëshoqërohet edhe opinioni juaj.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6?

Emilja Koliqi – Të lutem, edhe te neni 6.

Te neni 6 janë vendosur disa përkufizime dhe këto përkufizime, sipas praktikës legjislative, duhet të vendosen në krye, prandaj edhe këto t’ia çojmë komisionit përgjegjës.

Eduard Shalsi – Dakord, u mbajtën shënim?

Meri Kumbe – Po.

Neni 6. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Për miratimin e neneve 7 -16 u ndoq e njëjta procedurë.)

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Shumë faleminderit!

Po, zoti Leskaj, fjala është për ju.

Bujar Leskaj – Unë kam një propozim për komisionin. Pavarësisht shpjegimeve të zonjës zëvendësministre, unë propozoj që te neni 179, pika 11, të ardhurat nga gjobat të shkojnë te sporteli unik, SUADA dhe për agjencitë, jo te buxheti i shtetit. Ky është propozimi im.

Meri Kumbe – Bie ndesh me Kodin e Procedurave Administrative, që përcakton se gjobat duhet të derdhen në buxhetin e shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përgjigjet i keni të dërguara edhe me *email* në formë të shkruar dhe janë të gjitha të cituara dhe të sqaruara aty.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Falënderoj veçanërisht relatoren dhe anëtarët e komisionit për debatin parlamentar!

Ndërkohë, në orën 10:30 kemi takimin me delegacionin nga Kosova, ku do të diskutohet për objektivat e zhvillimit strategjik dhe gjithsecili prej jush është i ftuar të marrë pjesë.

Nesër kemi ligjin e *startup*-ëve.

Ditën e mërkurë kemi lënë dëgjesën me Guvernatorin në detyrë.

Shihemi pak më vonë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti